



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
Sekretaria

Nr. Prot.

Tiranë, më 24.10.2025

MBLEDHJA Nr. 43,
Datë 27.10.2025, ora 09:00
e Bordit të ERE-s.

Në zbatim të (i) nenit 13 dhe 16, të Ligjit Nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”; i ndryshuar, (ii) nenit 9, të “Rregullores së Brendshme të Organizimit dhe Funksionimit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE)”, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 199, datë 27.11.2020, e ndryshuar dhe (iii) nenit 8 dhe 11, të “Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016, njoftojmë se **ditën e Hënë, datë 27.10.2025, ora 09:00**, do të zhvillohet mbledhja nr. 43 e Bordit të ERE-s, sipas këtij rendi dite:

1. Mbi miratimin e procesverbalit të mbledhjes së Bordit të ERE-s më datë 21.10.2025.
2. Mbi kërkesën e shoqërisë “DRAGOBIA ENERGY” sh.p.k. për rinovimin e licencës në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.
3. Mbi miratimin e “Rregullores së alokimit të kapaciteteve afatgjatë (FCA)”.
4. Mbi miratimin e “Një udhëzuesi për balancimin e energjisë elektrike”.
5. Mbi fillimin e procedurës për shqyrtimin e kërkesës së OST sh.a. për miratimin e “Kodit të rrjetit mbi emergjencën dhe rivendosjen”.
6. Mbi shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “FTL” sh.a. lidhur me detyrimin e energjisë së rinovueshme.
7. Mbi disa ndryshime në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 40, datë 14.02.2025, “Mbi licencimin e shoqërisë “EB ENERGY” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 2 MW”.
8. Mbi disa ndryshime në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 68, datë 08.04.2025, “Mbi licencimin e shoqërisë “RENEW” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 2 MW”.

Palët e interesit për pjesëmarrje në mbledhjen e bordit të ERE-s, në ambientet e ERE-s ose nëpërmjet platformave të teknologjisë së komunikimit elektronik (online), duhet të dërgojnë me shkrim kërkesën për pjesëmarrje, në postën elektronike, në adresën erealb@ere.gov.al, jo më vonë se 24 orë para datës së njoftuar të mbledhjes, si dhe mënyrën e pjesëmarrjes dhe çështjen të cilën janë të interesuar të ndjekin.

KRYETARI
Petrit AHMETI